



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 21.2 dhe nenit 40.3 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, datë 4 qershor 2008),

Me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores Nr. 2/2009, për regjistrimin dhe shenjëzimin e mjeteve ajrore, datë 22 tetor 2009,

Me qëllim të implementimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 03/46, datë 02 nëntor 2011,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE NR. 11/2011
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR REGJISTRIMIN
DHE SHENJËZIMIN E MJETEVE AJRORE NR. 02/2009**

Neni 1

Neni 2, pas pikës (m) i shtohet ky përkufizim:

(o) **Mikro i lehtë** do të thotë një mjet ajror që nuk ka më tepër se dy ulëse, V_{SO} e të cilit nuk i kalon 35 nyje (65 km/h) CAS, dhe masa (pesha) maksimale e ngritjes (take-off) jo më e madhe se:

- 300 kg për aeroplanë tokësor (landplane), me një ulëse, ose
- 450 kg për aeroplanë tokësor (landplane), me dy ulëse, ose
- 330 kg për një amfib ose hidroplan me një ulëse, ose
- 495 kg për një amfib ose hidroplan, me dy ulëse, me kusht që mjeti ajror Mikro i Lehtë të jetë i aftë për të operuar si hidroplan dhe aeroplanë tokësor (landplane)
- bie poshtë kufijve të masës maksimale të ngritjes (MTOM), varësisht sipas rastit.

Neni 2

Neni 5 paragrafi 3, zëvendësohet me këtë paragraf:

5.3 Së bashku me aplikacionin për regjistrimin e mjetit ajror, aplikuesi do të paraqes dëshminë mbi pagimin e tarifës për regjistrim, siç përcaktohet me ligjin për aviacionin civil dhe rregulloren përkatëse të Autoritetit.

Neni 3

Nenit 8, i zëvendësohet titulli si në vijim:
“Shenjat e nacionalitetit”

Paragrafi 1 i këtij neni ndryshohet si në vijim:

“Shenjat e nacionalitetit të mjeteve ajrore të regjistruara në Republikën e Kosovës, përbëhen nga flamuri i Republikës së Kosovës dhe shenja Z6”.

Paragrafi 3 dhe 4 hiqen.

Neni 4

Pas nenit 8, shtohen nenet në vijim:

Neni 9

Shenja e regjistrimit

9.1 Shenja e regjistrimit e mjeteve ajrore të regjistruara në Republikën e Kosovës, përbëhet nga tri shkronja të shtypit të alfabetit romak, që i caktohen mjetit ajror nga Autoriteti.

9.2 Shkronja e parë e shenjës së regjistrimit mund të jetë çdo shkronjë e alfabetit romak, përveç atyre shkronjave të cilat caktohen si shkronja fillestare për këto lloje të mjeteve ajrore:

- a) B - balona,
- b) G - Velore (glajder),
- c) H - helikopterë,
- d) M - mjete ajrore mikro të lehta,
- e) P - mjete ajrore të policisë, dhe
- f) X - mjete ajrore eksperimentale.

9.3 Nuk duhet të akordohen nga Autoriteti, kombinimet e shkronjave të përdorura për shenjën e regjistrimit të cilat do të mund të ngatërroheshin me kombinimet pesëshkronjëshe që përdoren në Kodin Ndërkombëtar të Sinjaleve, Pjesa II, me

kombinimet tre-shkronjëshe që fillojë me Q të cilat përdoren në Kodin Q, dhe me sinjalin për ndihmë SOS, apo me sinjale të tjera urgjente.

Neni 10

Ekspozimi i shenjave: të përgjithshme

Çdo pronar i mjetit ajror duhet të ekspozojë shenjat të cilat përbëhen nga flamuri i Republikës së Kosovës, shenjën Z6 dhe shenjën e regjistrimit. Flamuri i Republikës së Kosovës duhet të vendoset para shenjave të nacionalitetit dhe regjistrimit dhe duhet të jetë i madhësisë dhe lartësisë së njëjtë me shenjat. Shenjat duhet të jenë pa ornamente, një vizë horizontale duhet të vendoset në mes të shenjave të nacionalitetit dhe atyre të regjistrimit.

Neni 9, bëhet neni 11, neni 10 bëhet neni 12, e kështu me radhë.

Neni 5

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 nëntor 2011.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i përgjithshëm